



Lufta kundër dhunës me bazë gjinore në BE

Mirela P. BOGDANI

Akademia ERA

1

- **Konventa e Stambollit**
- **Praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ-së**
- **Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**

2

Barazia

- **Vlerë themelore** e Bashkimit European
- Parashikuar në Traktatet Europiane, veçanërisht në Nenet 2 dhe 3(3) të Traktatit të Bashkimit European (TBE), Nenet 8, 10, 19, 153 dhe 157 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit European (TFBE) dhe Nenet 21 dhe 23 të Kartës së të Drejtave Themelore;
- Neni 23 i Kartës, barazia ndërmjet grave dhe burrave duhet të sigurohet **në të gjitha fushat**, duke përfshirë punësimin, punën dhe pagën

3

KONVENTA E STAMBOLLIT

KONVENTA e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje / 2011

<https://rm.coe.int/168008482e>

- Dhuna ndaj grave është një **formë e dhunës me bazë gjinore** që **ushtrohet kundër grave sepse ato janë gra**
- Shteti duhet ta trajtojë atë plotësisht, në të gjitha format e saj
- Të marrë masa për të parandaluar dhunën ndaj grave
- Të mbrojnë viktimat e dhunës në familje
- Të ndjekë penalisht autorët.
 - Nuk mund të ketë barazi të vërtetë midis grave dhe burrave nëse gratë përjetojnë dhunë të bazuar në gjini në një shkallë të gjerë dhe agjencitë dhe institucionet shtetërore mbyllin një sy.
 - **Burrat** gjithashtu mund të jenë subjekt i mbrojtjes së Konventës

4

Konventa e Stambollit Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje / 2011

- *Preambula*
- Kreu I - Qëllimet, përkufizimet, barazia dhe mosdiskriminimi, detyrimet e përgjithshme
- Kapitulli II – Politikat e integruara dhe mbledhja e të dhënave (*përfshirë Burimet financiare, OJQ-të dhe OSHC-të, organin koordinues, mbledhjen e të dhënave dhe hulumtimin*)
- Kapitulli III – Parandalimi
- Kapitulli IV – Mbrojtja dhe mbështetja
- Kapitulli V – E drejta lëndore (*paditë civile dhe mjetet juridike, kompensimi, veprat penale, lista e gjatë e DHBGJ-ve dhe DHF-së, ndalimi i zgjidhjes alternative të detyrueshme*)
- Kapitulli VI – Hetimi, ndjekja penale, e drejta procedurale dhe masat mbrojtëse (*hetimi, provat, ndihma juridike, procedimet ex parte & ex officio*)
- Kapitulli VII – Migracioni dhe azili
- Kapitulli VIII – Bashkëpunimi Ndërkombëtar
- Kapitulli IX – Mekanizmi i monitorimit – GREVIO

5

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mbi DHBGJ-në & DHF-në-a

6

Opuz kundër Turqisë - Kërkesa nr. [33401/02](#)

- Në vitin 1995, kërkuesja dhe nëna e saj paraqitën një ankesë kundër partnerëve të tyre, përkatësisht A.O dhe H.O në Zyrën e Prokurorisë Publike. Në ankesë pretendohet se A.O. dhe H.O. Kishin i **rrahur** dhe **kërcënuar**. Gjykata e Parë e Magjistrale dhe Gjykata e Dytë e Magjistrale e pushuan çështjen e rrahjes, pasi kërkuesja dhe nëna e saj i kishin tërhequr **ankimet e tyre**.
- Në vitin 1996, H.O. **e rrahu** përsëri kërkuesen, këtë herë **duke rrezikuar jetën e saj**. H.O. fillimisht u vendos në masën e sigurisë me burg, por më pas u lirua. Në seancën e radhës të gjykatës, kërkuesja e tërhoqi ankimin e saj. Sipas Kodit Penal turk, **ankimi i kërkueses ishte i nevojshëm për të vijuar procesin**, kështu që ai u ndërpre.

7

Opuz kundër Turqisë

- Në vitin 1998, H.O. **u nxori thikën** kërkueses, motrës dhe nënës së saj. Megjithatë, prokurori publik vendosi të mos ndjekë penalisht askënd në lidhje me këtë incident.
- Në vitin 1998, H.O. goditi me makinë kërkuesen dhe dhe nënën së saj, duke u shkaktuar **lëndime kërcënuese për jetën**. H.O. u vendos në paraburgim. Gjatë procesit, kërkuesja nëna e saj tërhoqën ankesat e tyre, duke deklaruar se ishte një aksident. Gjykata e pushoi çështjen.
- Në vitin 2001, H.O. e goditi kërkuesen **7 herë me thikë**. H.O. u dorëzua në një rajon policie, duke pretenduar se gruaja e tij e kishte sulmuar atë e para dhe u lirua. Avokati i nënës iu drejtua Zyrës lokale të Prokurorisë Publike, duke pretenduar se të dyja gratë ishin të detyruara të tërhiqnin ankimet e tyre për shkak të **kërcënimeve të vazhdueshme** me vdekje dhe kërkoi që H.O. të ndalohej. H.O.-së iu vendos një gjobë, e cila mund të paguhej në 8 këste.

8

Opuz kundër Turqisë

- Pas një ankimi tjetër nga nëna e kërkueses, H.O. u akuzua se kishte bërë **kërcënime me vdekje**. Nëna e kërkueses i kërkoi policisë të përgjonte telefonin e saj, por shoqëria telefonike nuk bashkëpunoi.
- Në vitin 2002, nëna e kërkueses u **vra me armë** nga H.O.-ja, ndërsa po përpiqej të transferohej në një qytet tjetër.
- H.O.-ja u dënua me pesëmbëdhjetë vjet e dhjetë muaj burgim dhe një gjobë prej 180 lira turke. Duke pasur parasysh kohën e kaluar nga i dënuari në paraburgim dhe faktin se vendimi do të shqyrtohej në apel, gjykata urdhëroi lirimin e H.O.-së.
- H.O.-ja filloi të **kërcënonte** sërish kërkuesen.

9

Opuz kundër Turqisë

- Në një praktikë të posaçme, GJEDNJ-ja iu referua jo vetëm **ligjit material dhe procedural**, por edhe **raporteve** lidhur me dhunën në familje dhe situatën e grave në Turqi. Raportet ishin me origjinë nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare. Këto raporte nxirrnin në pah **çështje serioze** në lidhje me:
 - Mungesën e zbatimit të ligjeve që mbrojnë gratë;
 - Në përgjigjetë kërkesave të bëra nga gratë në rrezik vdekjeje, gjykatat ende ishin duke i caktuar seancat dëgjimore me një diferencë kohore prej **dy ose edhe tre muajsh**;
 - Dhuna në familje **trajtohej ende me tolerancë** në rajonet policore;
 - Oficerët e policisë përpiqen të veprojnë si **arbitra**, ose të marrin anën e mashkullit, ose sugjerojnë që **gruaja të tërheqë ankimin e saj**.

10

Opuz kundër Turqisë

Çështje të tjera sipas këtyre raporteve ishin:

- **Vonesa të paarsyeshme** në nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes nga gjykatat;
- Trajtimi i ankimeve në lidhje me dhunën në familje **si një formë divorci**;
- **Dështimi i autoriteteve për të monitoruar** zbatimin e urdhrave;
- Oficerët e policisë e konsideronin dhunën në **familje si një çështje private** në të cilën policia ngurron të ndërhyjë;
- Policia nuk sigurohej që **urdhrat mbrojtëse (Urdhrat e Mbrojtjes) të zbatoheshin** në lidhje me autorët;
- Dënimet në lidhje me dhunën në familje zbuteshin në diskrecionin e gjyqtarëve, të cilët vazhdonin të marrin parasysh "**provokimin e rëndë**" të veprës penale ndaj zakoneve, **traditës ose nderit**.

11

Opuz kundër Turqisë - Shkelja e Nenit 2: E drejta për jetën

- Fjalja e parë i Nenit 2 § 1 kërkon që Shteti **jo vetëm të përmbahet** nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por edhe të **ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën**.
- Nëse ka një pretendim se autoritetet kanë shkelur detyrimin e tyre për të mbrojtur të drejtën e jetës, duhet të përcaktohet se **autoritetet e dinin ose duhet ta kishin ditur** në kohën e ekzistencës së një **rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën**.
- Në këtë rast, ishte e qartë se autori kishte një historik të dhunës në familje dhe prandaj kishte një rrezik të konsiderueshëm të dhunës së mëtejshme. Kështu, autoritetet lokale **mund të kishin parashikuar** një sulm vdekjeprurës nga H.O.-ja.

12

Opuz kundër Turqisë - Neni 2, Neni 8 i KEDNJ-së

Nëse viktimat e **tërheqin ankimin e tyre**, mund të merren parasysh disa **faktorë** gjatë vendim-marrjes për vazhdimin e ndjekjes penale:

- **graviteti i** veprës penale;
- nëse **lëndimet e viktimës** janë fizike apo psikologjike;
- nëse i pandehuri **ka përdorur një armë**;
- nëse i pandehuri ka bërë ndonjë **kërcënim** pas sulmit;
- nëse i pandehuri **e ka planifikuar sulmin**,
- **efektin** (duke përfshirë atë psikologjik) **për çdo fëmijë** që jeton në familje;
- gjendjen aktuale të **marrëdhënies së viktimës** me të pandehurin;
- **historikun kriminal të të pandehurit**, veçanërisht dhunën e mëparshme; etj.

Nuk duket se autoritetet lokale i kanë marrë në konsideratë mjaftueshëm faktorët e mësipërm kur në mënyrë të përsëritur kanë vendosur të ndërpresin procedimet penale në ngarkim të H.O.-së.

13

Opuz kundër Turqisë - Neni 2, Neni 8

- Ndërhyrja e autoriteteve të brendshme në jetën private ose familjare (*justifikimi i qeverisë për mosveprim ndaj sulmeve – duke ndërhyrë, institucionet shtetërore potencialisht mund të shkëlqin Nenin 8*) të individëve **mund të jetë e nevojshme** për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat e të tjerëve ose për të parandaluar kryerjen e veprimeve kriminale.
- Duke pasur parasysh gravitetin e krimeve të kryera ndaj viktimave nga H.O.-ja në të kaluarën, autoritetet e ndjekjes penale duhet të kishin qenë në gjendje të ndiqnin procedurat **si çështje me interes publik, pavarësisht tërheqjes së** ankimeve nga viktimat.
- Autoritetet turke **dështuan** në detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës së nënës së kërkueses brenda kuptimit të Nenit 2 të Konventës.

14

Opuz v. Turqi- Neni 3- Trajtimi çnjerëzor

- **Shtetet duhet të marrin masa** për të siguruar që individët të mos i nënshtrohen torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues, duke përfshirë keqtrajtimin nga **individë privatë**.
- Keqtrajtimi duhet të arrijë një **nivel minimal të ashpërsisë** që të përfshihet brenda fushëveprimit të Nenit 3, duke marrë parasysh:
 - natyrën dhe kontekstin e trajtimit;
 - kohëzgjatjen e tij;
 - efektet e tij fizike dhe mendore
 - seksin, moshën dhe gjendjen shëndetësore të viktimës
- Lëndimet fizike dhe presioni psikologjik në këtë rast ishin **mjaft serioze** për të arritur nivelin e keqtrajtimit brenda kuptimit të Nenit 3 të Konventës.

15

Opuz kundër Turqisë - Neni 14: Diskriminimi

- Pretendimi i diskriminimit në fjalë nuk ishte i bazuar në legjislacion *si i tillë*, por më tepër rezultoi nga **qëndrimi i përgjithshëm i autoriteteve lokale**, të tilla si:
 - mënyra se si gratë janë trajtuar në stacionet policore kur ato raportuan dhunën në familje;
 - pasiviteti gjyqësor në sigurimin e mbrojtjes efektive për viktimat.
- Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje të Nenit 14 të Konventës, të lexuar në lidhje me Nenet 2 dhe 3.

16

Durmaz kundër Turqisë / 2014

- Gjykata vendosi se kishte pasur **shkelje të Nenit 2** (e drejta për jetën) të Konventës në aspektin e saj procedural për shkak të **dështimit të autoriteteve turke për të kryer një hetim efektiv për vdekjen e** vajzës së kërkueses.
- Ashtu si në rastin Opuz, dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues gjyqësor në Turqi krijonte një klimë që ishte e favorshme për dhunën në familje.

17

Talpis kundër Italisë / 2017

- **Shkelja e Nenit 2** (e drejta për jetën) të Konventës për shkak të vrasjes së djalit të kërkueses dhe vrasjes së saj të mbetur në tentativë;
- Autoritetet Italiane **nuk arritën të ndërmerrnin veprime të menjëhershme** mbi ankesën e paraqitur nga kërkuesja, e privoi atë ankesë nga çdo efekt, duke krijuar një situatë mosndëshkimi që çon në përsëritjen e akteve të dhunës;
- ... Kërkuesja kishte jetuar me fëmijët e saj në një **klimë dhune mjaft serioze për t'u kualifikuar si keqtrajtim**, dhe se mënyra në të cilën autoritetet kishin kryer procedurat penale vuri në dukje pasivitetin gjyqësor, i cili ishte i papajtueshëm me Nenin 3.
- ... Shkelja e Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me Nenet 2 dhe 3, duke konstatuar se kërkuesja kishte qenë viktimë e diskriminimit si grua për shkak të **mosveprimit të autoriteteve**, të cilat kishin **nënvlerësuar dhunën në fjalë dhe kështu në thelb e kishin miratuar atë**.

18

Tershana kundër Shqipërisë / 2020

- Sulm me acid – me sa duket nga ish-bashkëshorti;
- **Asnjë shkelje e Nenit 2** (e drejta për jetën) të Konventës **në aspektin e saj lëndor**, duke konstatuar se shteti shqiptar nuk mund të mbahej përgjegjës për sulmin. Ajo vuri në dukje në veçanti se, nëse Shteti do të kishte qenë në dijeni të një rreziku për kërkuesen, do të kishte qenë detyra e tij të merrte masa parandaluese. Në rastin konkret, megjithatë, **autoritetet kombëtare kishin zbuluar vetëm sjelljen e dhunshme të ish-burrit të kërkueses pas incidentit.**
- Nga ana tjetër, Gjykata vendosi se kishte pasur një **shkelje të Nenit 2 në aspektin procedural**, duke konstatuar se **reagimi i autoriteteve ndaj sulmit me acid kishte qenë i paefektshëm** - hetimi për sulmin, i cili kishte shenjat dalluese të dhunës me bazë gjinore dhe për këtë arsye duhet të kishte nxitur autoritetet **të reagonin me kujdes të veçantë**, madje nuk kishte qenë në gjendje të identifikonte substancën e hedhur mbi të. Hetimi për më tepër u pushua në vitin 2010, pa identifikuar personin përgjegjës, dhe kërkueses nuk i është dhënë asnjë informacion në lidhje me progresin e tij që nga ajo kohë, pavarësisht kërkesave të saj të përsëritura.

19

X kundër Greqisë (2024) - Trajtimi i sulmeve seksuale

- **Përdhunimi dhe sulmet seksuale serioze** përfshihen brenda kufijve të **Nenit 3** të Konventës.
- **Intervistat me viktimat e dhunës seksuale duhet të kryhen nga një person i të njëjtit seks si viktima, në mënyrë që rrjedha e procedurës penale të mos paragjykohe.**
- **Natyrë intime** e çështjes, **mosha e re e kërkueses** dhe fakti që ajo pretendonte se **ishte përdhunuar gjatë pushimeve në një vend të huaj** ishin pika me ndjeshmëri të veçantë dhe kërkonte një qasje të ndjeshme.

20

Kurt kundër Austrisë (2021)

- **Shtrirja dhe përmbajtja e detyrimeve shtetërore** që lidhen me DHF-në janë si më poshtë:
- **Autoritetet duhet të reagojnë menjëherë** ndaj akuzave për dhunë në familje;
- Kur akuza të tilla vijnë në vëmendjen e tyre, **autoritetet duhet të verifikojnë nëse** ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e viktimës së identifikuar duke **kryer një vlerësim autonom proaktiv dhe gjithëpërfshirës të riskut të vdekshmërisë**.
- Autoritetet duhet të **vlerësojnë natyrën reale dhe të menjëhershme të riskut**, duke marrë parasysh kontekstin e veçantë të DHF-së;
- Nëse vlerësimi i riskut zbulon se ekziston një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën, **autoritetet duhet të marrin masa parandaluese operacionale dhe mbrojtëse për të shmangur këtë rrezik**.
- Masat duhet të jenë të **përshtatshme dhe proporcionale** me nivelin e riskut të vlerësuar.

21

Rekomandime praktike për avokatët që merren me rastet e dhunës në familje

- **Prioritizimi i sigurisë së viktimave:** Bëni kërkesë për urdhra mbrojtës sapo të shfaqet dhuna në familje
- **Inkurajimi i dokumentacionit:** Këshilloni klientët të dokumentojnë rastet e abuzimit (mbajtja e një ditari, ruajtja e mesazheve me tekst, fotot e lëndimeve).
- **Përdorni dëshminë e ekspertëve:** Sillni ekspertë (si punonjës socialë dhe psikologë) për të informuar gjykatën për çështjet që lidhen me traumën dhe sjelljen ose viktimën.
- **Mbrojtja e privatësisë së viktimave:** Ndërmerrni hapa për të mbrojtur identitetin dhe privatësinë e viktimave gjatë seancave gjyqësore, duke përfshirë mundësinë për seanca me dyer të mbyllura.
- **Shkeljet materiale dhe procedurale** (Neni 6 i KEDNJ)

22

Manual / OSBE 2013

Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje?

https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Domestic_violence_SQI

23

Manual/OSBE

- [Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Domestic_violence_SQI)

Manual/OSBE

24

Dokumente faktike përkthyer në shqip për DHF & DHBGJ

- https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Domestic_violence_SQI

25

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Maj, 2024

<https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1385/oj/eng>

26

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Një kornizë gjithëpërfshirëse për të **parandaluar** dhe **luftuar në mënyrë efektive** dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në të gjithë Bashkimin European. Ai e bën këtë duke forcuar dhe prezantuar **masa** në:
 - Përcaktimin e veprave penale dhe dënimeve përkatëse
 - Mbrojtjen e viktimave
 - Qasjen në drejtësi
 - Mbështetjen e viktimave
 - Mbledhjen e përmirësuar të të dhënave
 - Parandalimi
 - Koordinimin
 - bashkëpunimin

27

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- **Barazia** midis grave dhe burrave dhe **mos-diskriminimi** janë vlerat thelbësore të Bashkimit dhe të drejtat themelore të mishëruara, respektivisht, në **Nenin 2** të Traktatit për Bashkimin European – **TBE** dhe në **Nenet 21** dhe **23** të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European – **Karta**.
- Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje **i rrezikojnë këto vlera dhe të drejta**, duke minuar të drejtat e grave dhe vajzave për barazi në të gjitha fushat e jetës edhe duke penguar pjesëmarrjen e tyre të barabartë shoqërore dhe profesionale.

28

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është **shkelje e të drejtave themelore**
 - e drejta për dinjitet njerëzor
 - e drejta për jetën dhe integriteti i personit
 - ndalimi i trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës)
 - e drejta për për respektimin private dhe familjare
 - e drejta për liri dhe siguri
 - e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale
 - e drejta për mos-diskriminim, duke përfshirë edhe për shkak të seksit
 - të drejtat e fëmijës (siç parashikohet nga Karta dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e fëmijës)

29

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Të drejtat e viktimave duhet të zbatohen për të gjitha viktimat e sjelljes kriminale që përbën dhunë ndaj grave ose dhunë në familje, siç kriminalizohet sipas legjislacionit të BE-së ose atij kombëtar.
- Veprat penale të përcaktuara në direktivë
- Gjymtimi gjenital femëror
- Martesë e detyruar
- Ndarja jo konsensuale e materialit intim ose të manipuluar
- Kërcënimet kibernetike, ngacmimet kibernetike, nxitja kibernetike dhe sulmet kibernetike ndaj dhunës ose urrejtjes, të parashikuara nga akte të tjera ligjore të Bashkimit

30

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Legjislacioni material dhe procedural
- Prova
- Qasja
- Kompensimi
- Shërbime të specializuara mbështetëse (të përshtatura për viktimat) – akses / qendrat dhe qendrat për rastet e përdhunimeve
- Trauma dhe procesi i rimëkëmbjes
- Staf i trajnuar
- Ndihma nëpërmjet telefonit
- Fëmijët e viktimave të DHF-së mund të përfitojnë plotësisht nga kjo direktivë

31

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Parandalimi
- Minimizoni risqet
- Politika të koordinuara
- Shtetet Anëtare sigurojnë koordinimin minimal të politikave në nivel qendror, si dhe, sipas rastit, në nivel rajonal ose lokal
- Roli i OJQ-ve/OSHQ-ve
- Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe konsultimi në raste individuale, brenda mandateve të Eurojust-it, Rrjetit Gjyqësor European në çështje penale dhe agjencive të tjera përkatëse të Bashkimit

32

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Neni 2 – *Përkufizime*
- Kapitulli II - Veprat penale në lidhje me shfrytëzimin seksual të grave dhe fëmijëve dhe krimin kompjuterik
 - Të gjitha llojet e veprave penale të DHBGJ-ve dhe DHF-ve
 - Sanksionet
 - Rrethana rënduese
- Kapitulli III – Mbrojtja e Viktimave dhe Aksesit në Drejtësi
 - Raportimi
 - Hetim dhe ndjekje penale
 - Identifikimi i nevojave të viktimave për mbështetje
 - Mekanizmi i referimit – Urgjenca e bllokimit/frenimit/urdhrrat e mbrojtjes
 - Mbrojtja e jetës private
 - Kompensimi i viktimave (nga autorët e veprave penale)

33

Direktiva e BE-së në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave & dhunës në familje

- Kapitulli III – Përkushtuar MBËSHTETJES së VIKTIMAVE
 - Mbështetje e specializuar (për të gjitha llojet e DHBGJ-ve & DHF-ve)
 - Ndihma nëpërmjet linjave telefonike
 - Strehimore dhe akomodimet e tjera të përkohshme
 - Mbështetja e fëmijëve viktimë
 - Siguria e fëmijëve

Kapitulli iv - Parandalimi dhe ndërhyrja e hershme

- Masat parandaluese
- Parandalimi i dhunës
- Trajnimi dhe informimi i profesionistëve
- Programet e ndërhyrjes

34